



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHENDETESISË-MINISTARSTVO ZDRAVSTVA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinstvo Org. Unit	09
Kodi Post. Post. Code Postcode	05-6239
Nr. i faqesha Broj stranica No. pages	- 6 -
Dave Datum Date	06/10/2023
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

KONTRATË PUBLIKE

FURNIZIM

Titulli: **“Furnizim me material higjienik për Shtëpinë e Fëmive
me Aftësi të Kufizuar- SHFAK”**

Numri i kontratës 1: 206-23-9546-1-3-6/C462

Numri i Prokurimit: 206-23-9546-1-3-6

Operatori ekonomik: **PM GROUP SH.P.K.**

NUI: 810846230

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

MINISTRIA E SHËNDETËSISË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëzën anë; dhe

PM GROUP SH.P.K., Anton Çetta, PRISHTINË, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Furnizim me material higjienik për Shtëpin e Fëmive me Aftësi të Kufizuar- SHFAK me numër identifikues: 206-23-9546-1-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Furnizim me material higjienik për Shtëpin e Fëmive me Aftësi të Kufizuar-SHFAK

1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin nga të dyja palët dhe përfundon pas kryerjes së furnizimeve.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së urdhëresës nga AK

1.4 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: Shtëpia e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar- SHFAK

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP (Detyra e Dërguar e Paguar).

Nr. rend	Emertimi I Artikullit	Njësia	Sasia	ÇMIMI PËR NJËSI PA TVSH €	TVSH (%)	ÇMIMI PËR NJËSIME TVSH	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1	Brush e but me bisht (gelqerosje) 26x 4.5 cm bisht 120 cm	Copë	5	0.85	18%	1	5.00
2	Brion (ose ekuivalent) per ftyr 160ml	Copë	6	1.27	18%	1.5	9.00
3	Brush e fort për patos me bisht	Copë	4	0.68	18%	0.8	3.20
4	Brush për dhëmbë	Copë	50	0.13	18%	0.15	7.50
5	Brush për shkumë rruarje	Copë	4	0.17	18%	0.2	0.80
6	Brush për WC me mbajts plastik	Copë	6	0.68	18%	0.8	4.80
7	Deodorant sprej 1/180 ml	Copë	50	0.72	18%	0.85	42.50
8	Detergjent për makinë të enëve 1.5 kg	Kg	80	2.71	18%	3.2	256.00
9	Detergjent për pastrimin e rrobave kualitet i lartë dhe i atestuar	Kg	150	0.55	18%	0.65	97.50
10	Dezinfektus për banjo dhe toalt (domestos 750 ml ose ekuivalent)	Copë	75	0.68	18%	0.8	60.00
11	Dorëza gome per pastrim të trasha	Copë	5	0.85	18%	1	5.00
12	Foli alumini standard pako 1 copë 20 ml rolle30cm gjatesi	Copë	40	0.59	18%	0.7	28.00
13	Foli celofoni 10 m	Copë	40	0.59	18%	0.7	28.00
14	Freskus ajri (freskus aromatik të ajrit) 250 ml	Copë	25	0.68	18%	0.8	20.00
15	Fshis dore e thjesht me fije kasht me bisht të gjatë	Copë	3	0.42	18%	0.5	1.50
16	Fshis ë dore e thjesh me fije plastike me bisht të gjatë	Copë	12	1.23	18%	1.45	17.40
17	Gërrys gome për dysheme me bisht 35 cm	Copë	15	0.85	18%	1	15.00
18	Gomë me shkop druri 50 cm për lirimin e WC(vakum gome)	Copë	6	0.34	18%	0.4	2.40
19	Kese për friz 1/10	Copë	4	0.25	18%	0.3	1.20

² Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

20	Kovë për xhoker (me shtrydhëse me vi balerina me form ovale me rrjet për shtrydhje	Copë	8	2.46	18%	2.9	23.20
21	Krahër për flokë	Copë	5	0.42	18%	0.5	2.50
22	Kripë për makinë të enëve 1/1	Kg	12	1.27	18%	1.5	18.00
23	Leckë lëkure për pastrim tip top 40 cm x 30cm ekuivalent	Copë	20	0.68	18%	0.8	16.00
24	Leckë magjie (mikrofiber) për dritare 40 30 cm	Copë	20	0.25	18%	0.3	6.00
25	Lopat e vogel e plastikes	Copë	6	0.25	18%	0.3	1.80
26	Makinë për prerjen e thonjëve	Copë	10	0.42	18%	0.5	5.00
27	Mbulesa leter për tavolina për një përdorimshe	Copë	200	0.07	18%	0.08	16.00
28	Pastë pavloderm ose ekuivalent 1/150ml	Copë	12	0.85	18%	1	12.00
29	Pastë për dhëmbë	Copë	100	0.72	18%	0.85	85.00
30	Peshkira për duar pambuku 40 x 70 cm	Copë	100	0.72	18%	0.85	85.00
31	Peshkira për pastrim 2 m x 80 cm	Copë	25	2.54	18%	3	75.00
32	Preparat për pastrimin e yndyrnave I lëngës hem 500 ml	Copë	5	0.85	18%	1	5.00
33	Qese 5 kg (100 cop)	Copë	12	0.85	18%	1	12.00
34	Salveta për terjen e enëve 20 x 30 cm	Copë	60	0.34	18%	0.4	24.00
35	Sapuna për rroje arko ose ekuivalent 75 gr	Copë	12	0.85	18%	1	12.00
36	Shampon për duar me pompë 500 ml	Copë	100	0.51	18%	0.6	60.00
37	Shampon për dysheme 1000 ml	Copë	75	0.51	18%	0.6	45.00
38	Shampon për enë standard 1000 ml	Copë	150	0.51	18%	0.6	90.00
39	Shampon për flokë 1000 ml	Copë	150	0.76	18%	0.9	135.00
40	Shampon për furrë elektrike 750 ml	Copë	20	0.76	18%	0.9	18.00
41	Shampon për kanalizim 750 ml	Copë	30	0.81	18%	0.95	28.50
42	Shampon për makinë të enëve jo jonik 1 lit	Copë	100	1.02	18%	1.2	120.00
43	Shapon për njolla 450 ml vanish ose ekuivalen	Copë	75	0.85	18%	1	75.00
44	Shport për rroba 90 lit	Copë	2	2.54	18%	3	6.00
45	Shpuza me dy anë njera e butë tjetra e vrzhde	Copë	150	0.05	18%	0.06	9.00
46	Sprej anti insekte 40 ml	Copë	12	0.85	18%	1	12.00
47	Sprej për xhama 750 ml	Copë	50	0.55	18%	0.65	32.50
48	Sungjer dy anet e buta 17 x 16 x 2 cm	Copë	35	0.17	18%	0.2	7.00
49	Tela për enë 1/6	Copë	60	0.34	18%	0.4	24.00
50	Thartinë (kiselin) 100 % pako plastike 1/1 lit	Copë	30	0.68	18%	0.8	24.00
51	Thas PVC për mbeturina 150 lit 1/10	Copë	200	0.34	18%	0.4	80.00
52	Trolleksi të kualitetit të lartë mikrofiber 1 x 3 original	Kompl	20	0.47	18%	0.55	11.00
53	Vatë higjenike standard	Copë	150	0.59	18%	0.7	105.00
54	Zbardhues (varekin ose ekuivalent)	Copë	10	0.51	18%	0.6	6.00
55	Zhileta ose ekuivalent tehe I briskut për rroje 1/5	Copë	20	0.30	18%	0.35	7.00
Totali i Përgjithshëm (DDP):							1,898.30 €

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **1,898.30 €**; [*njëmijë e tetëqindëntëdhjetetë euro e tridhjetë cent*].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 6 muaj, pas pranimit të shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *shërbimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën kompetente në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe³ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Menaxheri i kontratës nga SHFAK është: Znj. Jetimire Imeri

Telefoni:

Personi kontaktues nga OE: Pashtrik Mustafa

Telefoni: 048/881-999

E-mail: shpkpmgroup@gmail.com

Për Autoritetin Kontraktues		Për Furnizuesin	
Emri:	Berat Marmullaku	Emri:	PASHTRIK MUSTAFA
Pozita:	Udhëheqës i Div. te Prokurimit	Pozita:	DREKTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	05.10.2023	Data:	05.10.23
Vula:		Vula:	

³Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **118229**

Për **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **PM GROUP SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **FURNIZIM ME MATERIAL HIGJENIK PER SHTËPINË E FËMIJEVE ME AFTESI TE KUFIZUAR - SHFAK.**

Nr. prokurimit: 206-23-9546-1-3-6/C462 , Nr. brendshëm: 206-23-9546-1-3-6

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **189.63€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkakuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **189.63€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 180 ditë kalendarike prej **05.10.2023** deri më **02.04.2024**

Data lëshimit: 05.10.2023

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.

